

VENDIM
Nr. 155, datë 31.7.2024

MBI ZGJATJEN E AFATIT TË VENDIMMARRJES SË BORDIT TË ERE-s PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË “FAETHON” SHPK PËR LICENCIM NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; nenit 14, pika 3, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 31.7.2024, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1125/8 prot., datë 29.7.2024, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘Faethon’ sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Shoqëria “Faethon” sh.p.k. me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1125 prot., datë 21.5.2024, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaiik, me kapacitet prodhues 93 mw, me vendndodhje në zonën kadastrale nr. 2444, Bashkia Libohovë, qarku Gjirokastrë.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 104, datë 31.5.2024, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “Faethon” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaiik me kapacitet të instaluar 93 mw, me vendndodhje në zonën kadastrale nr. 2444, Bashkia Libohovë, qarku Gjirokastrë.

- ERE botoi njoftimin në medien e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 4.6.2024 dhe 5.6.2024) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 3.7.2024), nuk rezultoi të ketë të tilla. Njoftimi për fillimin e procedurës u botua edhe në faqen zyrtare të internetit të ERE-s.

- ERE, me shkresën nr. 1481, datë 6.6.2024, ka njoftuar Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për fillimin e kësaj procedure dhe me shkresën nr. 1125/3 prot., datë 4.6.2024, i është drejtuar shoqërisë, duke i njoftuar vendimin e fillimit të procedurës dhe duke i kërkuar plotësimin e informacionit/dokumentacionit të konstatuar të munguar apo plotësuar pjesërisht.

- Me *e-mail*-in e protokolluar në ERE me nr. 1125/4 prot., datë 19.6.2024, shoqëria ka depozituar një pjesë të dokumentacionit të konstatuar të plotësuar pjesërisht dhe ka kërkuar mirëkuptimin e ERE-s, për të plotësuar brenda një kohe të arsyeshme pjesën e mbetur të dokumentacionit, i cili duhet të merret në Greqi, për shkak se 3 administratorët e saj janë shtetas grekë dhe aktualisht rezidentë në Greqi.

- ERE, me shkresën nr. 1125/5 prot., datë 28.6.2023, i është drejtuar shoqërisë me kërkesën për informacion, në lidhje me afatin e arsyeshëm, brenda të cilit ajo do të plotësojë dokumentacionin e aplikimit të saj. Në vijim, me shkresat nr. 125/7 prot., datë 23.7.2024, shoqëria ka depozituar dokumentacion plotësues të aplikimit.

- Pas shqyrtimit të këtij dokumentacioni në referencë të përcaktimeve të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar, rezulton se nga ana e shoqërisë duhet të plotësohet dhe sa vijon:

NENI 9

Formati dhe dokumentacioni për aplikim

Pika 1. Dokumentacioni i përgjithshëm për të gjitha aplikimet për pajisje me licencë

Pika 1.3. Dokumentacioni financiar dhe fiskal

- **Germa “b”:** Shoqëria duhet të depozitojë në ERE dokumentacion vërtetues që ortaku kryesor i saj e disponon shumën që do të vendosë në dispozicion të ndërtimit të parkut fotovoltaiik; dokumentacion vërtetues për pjesën e mbetur të vlerës së investimit; saktësimin e modalitetit të ri të financimit.

Pika 2. Dokumentacioni specifik sipas tipit të licencës

Pika 2.1 Për t’u pajisur me licencë për prodhimin e energjisë elektrike, aplikuesi duhet të depozitojë, gjithashtu:

- **Germa “c”:** Shoqëria duhet të depozitojë në ERE miratimin përfundimtar/marrëveshjen e nënshkruar me OST sh.a. për miratimin e pikës së lidhjes me rrjetin e transmetimit.

- Po ashtu, shoqëria duhet të depozitojë dokumentacion teknik mbështetës, në lidhje me jetëgjatësinë e pritshme të centralit fotovoltaiik (si p.sh.: garancia e paneleve të përzgjedhura për parkun fotovoltaiik).

- Në nenin 14, pika 3, të rregullores, parashikohet, se: “Bordi mund të vendosë rast pas rasti për zgjatjen e afatit për marrjen e vendimit përfundimtar për pranimin ose refuzimin e aplikimit për licencë kur dokumentacioni nuk është i plotë, por jo më shumë se 30 ditë.

- Për gjithë sa më sipër, me qëllim zhvillimin e korrespondencës së mëtejshme me shoqërinë për të sqaruar informacionin/dokumentacionin që ka mbetur ende për t’u plotësuar dhe depozitim të tij në vijim në ERE, vlerësojmë të zgjatet deri në 30 (tridhjetë) ditë afati i vendimmarrjes së Bordit të ERE-s për kërkesën e shoqërisë “Faethon” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike. Shoqëria duhet të depozitojë këtë informacion/dokumentacion në ERE brenda 20 (njëzet) ditëve.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të zgjasë deri në 30 (tridhjetë) ditë afatin e vendimmarrjes së Bordit të ERE-s për kërkesën e shoqërisë “Faethon” sh.p.k., për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.

2. Shoqëria duhet të depozitojë në ERE informacionin/dokumentacionin e munguar të aplikimit brenda 20 (njëzet) ditëve, përshirë dhe çdo komunikim të nevojshëm me institucion /organet e tjera

3. Drejtorja e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë shoqërinë “Faethon” sh.p.k. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti